



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 571/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci, Kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Kushtrim Zuka, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK), me seli në Ferizaj, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 04.03.2021, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 05.03.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.571/2021 i datës 04.03.2021, i parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK), me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave në Komunën e Ferizajit, Lipjanit, Prishtinës dhe Fushë Kosovës.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.03.2021, nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK), duke pretenduar se Komunën Ferizajit, Lipjanit, Prishtinës dhe Fushë Kosovës votat tona nuk korespondojnë dhe përputhen në rezultatin final.

Parashtruesi i apelit ka kërkuar nga PZAP-i, që të rinumrohen votat e të gjitha Vendvotimeve në Komunën Ferizajit, Lipjanit, Prishtinës dhe Fushë Kosovës.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Apeli është i pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i apelit kërkon që të rinumërohen të gjitha kutitë e votimit në Komunën Ferizajit, Lipjanit, Prishtinës dhe Fushë Kosovës.

Pretendimet në apel me asnjë provë bindëse nuk i ka dëshmuar se në cilat vendvotime iu janë bërë parregullsi, ashtu siç pretendon, prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, apelin e parashtruar e konsideron si të përgjithshëm dhe të pa bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Prandaj, PZAP-i, konstatoi se pretendimet në apel janë të pabazuara ngase parashtruesi i apelit nuk ka ofruar asnjë dëshmi për t'i vërtetuar dyshimet e tij të pretenduara në apel edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e apelit, po ashtu nuk ka dhënë asnjë udhëzim apo hollësi se ku mund të gjenden dëshmitë, të cilat nuk i ka pasur në posedim lidhur me atë çka pretendon në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.571/2021 më datën 05.03.2021

**Kryesuesi i Panelit**

**Adnan Konushevc**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.